



Memorandum Mirëkuptimi

në mes

Kosova - Women 4 Women
dhe
Komuna e Gllogocit

Ky Memorandum Mirëkuptimi (në tekstin e mëtejmi referuar si 'Memorandumi') ka për synim krijimin e partneritetit mes Kosova -Women 4 Women (në vazhdim i referuar si 'KW4W') dhe Komunës së Gllogocit (ne vazhdim i referuar si 'Komuna').

Ky dokument nuk paraqet marrëveshje që i lidh palët ligjërisht në implementim të aktivitetetave të ndryshme për synime të përbashkëta, mirëpo i elaboron kushtet në bazë të të cilave do të funksionojë ky bashkëpunim si dhe rolet dhe përgjegjësitë e secilës palë.

I. Objektivat e bashkëpunimit

Qëllimi i Memorandumit është që të ofrojë kornizën e bashkëpunimit dhe koordinimit në mes palëve me qëllim të fuqizimit ekonomik dhe social të grave të kësaj komune dhe rritjes së pjesëmarrjes së grave në procese të ndryshme vendimmarrëse dhe afariste.

II. Rolet dhe përgjegjësitë

Duke e nënshkruar këtë memorandum, palët pajtohen t'i përmbushin rolet dhe përgjegjësitë në vazhdim:

- KW4W do të ketë përgjegjësi:
 - Të bëjë mobilizimin e grave dhe burrave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
 - Të bëjë organizimin e trajnimeve,
 - Ti koordinoj aktivitetet me zyrtarë/ et komunalë

b. Komuna do të ketë përgjegjësi:

- Të emëroj një zyrtar/e si person kontaktues për koordinim të aktiviteteve,
- Të bashkëpunojë në mobilizimin e grave për pjesëmarrje në aktivitete dhe programe,
- Aty ku është e mundur të ofroj hapësira për nevoja të aktiviteteve dhe projekteve
- Komuna e Gllogocit nuk ka asnje obligim financiar ne kete memorandum.
- Ne varesi te mundesive buxhetore dhe me Anex marreveshje, do te bashkefinancoj projektet specifike perkrahese te K-W4W per perfitureset e Komunes se Gllogocit.

III. Konfidencialiteti

Të dyja palët pajtohen që të dhënat dhe informatat që merren/grumbullohen përgjatë këtij bashkëpunimi do të trajtohen me konfidencialitet dhe sipas ligjeve të Kosovës. Edhe pas përfundimit të projektit informatat personale të rasteve mund të përdoren vetëm me miratimin me shkrim të tyre.

IV. Kohëzgjatja e Memorandumit të Mirëkuptimit

Ky memorandum hyn në fuqi me datën e nënshkrimit dhe do te mbes ne fuqi deri me 31 dhjetor 2029.

Në rast se ndonjëra palë dëshiron ta ndërpresë marrëveshjen, duhet të bëhet njoftim me shkrim 1 muaj përpara se marrëveshja të konsiderohet e ndërprerë.

Palët minden, me marrëveshje të dyanshme me shkrim, të ndryshojnë apo plotësojnë këtë marrëveshje.

V. Autorizimi

Duke e nënshkuar këtë memorandum, të dyja palët pajto që t'i përbushin termet e saj në mirëbesim. Edhe pse kjo marrëveshje nuk është obligative ligjërisht për ta implementuar, ajo është dëshmi e përkushtimit për t'i zbatuar rolet dhe përgjegjësitë e paracaktuara në këtë marrëveshje.

Kosova - Women 4 Women

Emri: Iliriana Gashi




Titulli: Drejtore

Adresa: Arbëria III, Rruga Kosturi, nr. 69
10000 Prishtina

Data: 10.6.2025

Komuna e Gllogocit

Emri: Ramiz Lladrovci



Titulli: Kryetar i Komunes

Adresa: rr.Fehmi e Xheve Lladrovci

13000, Gllogoc

Data: 10/06/2025

